

Tiranë, më 28 Maj 2021

KËRKESË PËR OFERTË

SUBJEKT TREGTAR/KOMPANI UDHËTIMESH PËR PRENOTIMIN DHE BLERJEN E 12 BILETAVE UDHËTIMI PËR 6 PJESËMARRËS (VAJTJE-ARDHJE) MAL I ZI-SHËNGJIN- MAL I ZI, BLERJEN E 12 BILETAVE UDHËTIMI PËR 6 PJESËMARRËS (VAJTJE-ARDHJE) KOSOVË-SHËNGJIN- KOSOVË, BLERJEN E 12 BILETAVE UDHËTIMI PËR 6 PJESËMARRËS (VAJTJE-ARDHJE) MAQEDONI E VERIUT-TIRANË- MAQEDONI E VERIUT DHE BLERJEN E BILETAVE PËR 24 PJESËMARRËS (VAJTJE DHE KTHIM PAS 5 DITËSH TIRANË-SHËNGJIN-TIRANË).

Hyrje

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), në zbatim të projektit “Drejt një dialogu më të madh ndërkulturor, ndërbesimtar dhe ndërjetar në Ballkanin Perëndimor”, mundësuar dhe mbështetur financiarisht nga organizata jofitimprurëse donatore DRA, Civic Solidarity Platform dhe Zyra Federale e Jashtme e Republikës Federale të Gjermanisë, shpall kërkesën për ofertë për një subjekt tregtar/kompani udhëtimesh për prenotimin dhe blerjen e 12 biletave udhëtimi për 6 pjesëmarrës (vajtje-ardhje) Mal i Zi-Shëngjin- Mal i Zi, blerjen e 12 biletave udhëtimi për 6 pjesëmarrës (vajtje-ardhje) Kosovë-Shëngjin- Kosovë, blerjen e 12 biletave udhëtimi për 6 pjesëmarrës (vajtje-ardhje) Maqedoni e Veriut-Tiranë-Maqedoni e Veriut dhe blerjen e biletave për 24 pjesëmarrës (vajtje dhe kthim pas 5 ditësh Tiranë-Shëngjin-Tiranë).^{*1}

KShH fton të gjitha subjektet/kompanitë e interesuara që të dërgojnë në formë elektronike në adresën e e-mailit të KShH-së office@ahc.org.al ose postare, deri në datën 03.06.2021, dokumentacionin e mëposhtëm:

- 1. Ofertën financiare në Euro (me TVSH të përfshirë) ^{*2}**
- 2. Çertifikatën e regjistrimit (nqs ofertuesi është kompani/subjekt tregtar)**
- 3. Oferta duhet të jetë e firmosur dhe e vulosur**

¹ *Preferohet udhëtimi me minibus të rezervuar

² *Subjektet që nuk i nënshtrohen TVSH ta deklarojnë këtë status.